



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	10.07.2023
Për:	Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim vendim për ndryshimin e emblemës së Komunës së Gjakovës

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 7 paragrafi 3, nenin 58 shkronja (h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si nenin 4 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Gjakovës të miratuar me datë 28.12.2022, Kryetari i Gjakovës me datë 10.07.2023 parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

PROPOZIM VENDIM

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miratojë vendimin për ndryshimin e emblemës së Komunës së Gjakovës, sipas propozimit të përzgjedhur nga Komisioni përkatës, i themeluar nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës.
2. Obligohen organet e administratës për kryerjen e të gjitha procedurave konform dispozitave ligjore në fuqi, që të inkorporojnë në të gjitha fushat e nevojshme emblemën si në këtë propozim vendim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe administrata e Komunës së Gjakovës.
4. Me miratimin e këtij propozim vendimi për ndryshimin e emblemës së Komunës së Gjakovës, me automatizëm kjo emblemë inkorporohet në të gjitha aktet e Komunës së Gjakovës, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës.
5. Pjesë përbërëse e këtij Propozim vendimi është:
- Materiali për emblemën e propozuar.

Me respekt!